



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.502/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “AL Petrol” SH.P.K. me seli në fshatin Vragoli, Fushë Kosovë, përfaqësuar sipas autorizimit nga E.F., kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit Nr. 5042 të datës 18.08.2020, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 18.03.2024 me pjesëmarrje të përfaqësueses së autorizuar të paditësit dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt konform nenit 41 të LKA, me datë 25.03.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “AL Petrol” SH.P.K. me seli në fshatin Vragoli, Fushë Kosovë, kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë me çka ka kërkuar anulimin e vendimit Nr. 5042 të datës 18.08.2020, **si e bazuar**.

- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 03.09.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative së “AL Petrol” SH.P.K. me seli në fshatin Vragoli, Fushë Kosovë, përfaqësuar sipas autorizimit nga E.F., ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë

e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me kërkesëpadi për anulim të vendimit Nr. 5042 të datës 18.08.2020, si paligjshëm dhe i pasafatshëm dhe të obligohet e paditura t'ia paguaj shpenzimet procedurale. Lënda është evidentuar me nr. A.1456/2020.

2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA 502/22.
3. Me datë 18.03.2024 gjykata caktoi dhe mbajti shqyrtimit kryesor publik me pjesëmarrje të përfaqësueses së autorizuar të paditësit sipas autorizimit LRP.3888/2023 me datë 03.04.2023 dhe në mungesë të përfaqësuesit ë paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt, konform nenit 41 të LKA-së, ftesën për seancë e ka pranuar me datë 21.02.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesja e palës paditëse në padi dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vendimi kontestues Nr.Prot:5042 i datës 18.08.2020, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që e rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, neni 47, par.1 pika.1.1 e LKA-së sepse pjesa hyrëse nuk përmban emrin e atij që i drejtohet akti, nuk përmban shënimin e shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes. Dispozitivi i vendimit kontestues është marre me shkelje të dispozitës 47.par 1, pika.1.2 të LKA-së se nuk përmban detyrimin sic theksohet në par.8 të arsytimit, pra dispozitivi është në kundërshtim me arsytimin. Vendimi kontestues është nxjerrë në kundërshtim me nenin 48 par.1 pika 1.1 1.2, 1.3 dhe 1.5 të LKA-së sepse arsytimi i tij nuk përmban paraqitjen e shkurtër të paditësit, nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, nuk përmban shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, nuk përmban shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjë nga pretendimet ankimore të paditësit, këto fakte tregojnë se arsytimi i vendimit kontestues është i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me nenin 48 par.2 të LPPA-së. Vendimi kontestues është i paligjshëm se është shkelur dispozita e nenit 52 par.1 pika 1.3 dhe 1.4 e LPPA-së , se vendimi i marrë është rezultat i shkeljes se dispozitave të lartcekura.

5. Po ashtu ka deklaruar se vendimi kontestues është në kundërshtim më ligjin material, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt pa vlerësuar fare pretendimi ankimore të paditësit, sepse në vendimin për shqiptimin e gjobës, të datës 28.07.2020, e paditura kundërligjshëm ka aplikuar dispozitën e nenit 14 .1 14.2 dhe 14.3 të Ligjit nr.2004/5 për Tregti me Naftë dhe Derivate të naftës, se pika 14.1 përcakton se Ministria do të lëshoj urdhëresë dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji. Pika 14.2 përcakton mbikëqyrjen për zbatimin e këtij ligji e bene Ministria dhe pika 14.3 përcakton se inspektimin e bene inspekcioni kompetent dhe organet e autorizuara ne këtë dhe ligjet tjera.
6. Ne vendimin e atakuar dhe në vendimin për shqiptimin e gjobës të datës 28.07.2020 nuk janë shqyrtuar pretendimet ankimore të paditëses për aplikimin e gabuar të bazës ligjore të nenit 26 par.26.3 të Ligjit nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut. Nuk është shqyrtuar pretendimi ankimor për shkelje të nenit 26 par.4 të Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, pasi vendimi për shqiptimin e gjobës është i pas afatshëm se nuk është marrë ne afat prej 8 ditësh nga dita e përpilimit të procesverbalit të inspektoreve të datës 09.06.2020, se nga kjo datë e deri me datën 28.07.2020 kanë kaluar më tepër se 8 ditë, gjithsej kanë kaluar 48 ditë që inspektorët e tregut nuk e kanë marrë vendimin për shqiptimin e gjobës brenda afatit ligjore që vërtetohet nga vula e protokollimit të vendimit të atakuar. Në vendimin kontestues nuk është vlerësuar as pretendimi ankimor i paditëses me nenin 98 par.1 dhe 2 të LPPA-së , për mos përfundimi i procedurës administrative me afatin 45 ditësh. Për të gjitha këto arsye i propozon gjykatës ta aprovoj padinë në tërësi, ta anuloj vendimin kontestues për shqiptimin e gjobës si të pas afatshëm të datës 18.08.2020 si të pabazuar në ligj

Kundërshtimet e të paditurës

7. E paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, në përgjigje në padi të datës 26.01.2024 ka deklaruar Ligji Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, Neni 6 përcakton që Inspektorati gjate veprimtarisë se tij duhet te bazohet ne metodën e vlerësimit të rrezikut qe sjell tregu dhe produktet e tregut për jetën, shëndetin dhe

sigurinë e qytetareve. Inspektori i tregut për shkeljet e konstatuara me këtë ligj shqipton gjoba konform Ligjit nr. 02/L-28 Per Procedurën Administrative neni 136. Inspektorati i Tregut si organ ekzekutiv ne kuadër te Ministrisë se Tregtisë dhe Organi i shkalles se dyte pranë Inspektoratit i Tregut pasi ka shqyrtuar ankesën e paditësit ka gjetur se me vendimin e atakuar me ankese, gjendja faktike ishte vërtetuar ne mënyrë te drejtë dhe janë të pabazuara pretendimet ankimore te paditësit. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë dhe të mbete në fuqi Vendimi i Inspektoratit te Tregut Protokolli nr. 5042 i datës 18.08.2020.

8. Inspektorati i Tregut i MINT në përgjigje në padi të datës 29.01.2024 me Aktvendimi me nr. Prot. 19/4217 te datës 28/07/2020 operatorit ekonomik Al Petrol sh.p.k, i kane shqiptuar gjobe, në vlere prej 1,000.00 (njëmijë) euro. Kundër aktvendimit te lartcekur me date 03/08/2020, operatori ekonomik Al Petrol shpk ka parashtruar ankese me nr. prot. 19/4327 me te cilën ka kundërshtuar aktvendimin e nxjerr nga inspektorët e tregut. Kryeinspektori i Inspektoratit Qendror te Mbikëqyrjes së Tregut - MINT, ka shqyrtuar dhe analizuar ankesën e operatorit ekonomik dhe ka nxjerr Vendim me nr. Prot. 19/5042 te datës 18/08/2020 me te cilin ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik Al Petrol shpk, ndërsa ka lënë ne fuqi Aktvendimin me nr. 19/4217 te datës 28/07/2020 me arsyetimin se inspektorët e tregut kane vepruar ne harmoni me dispozitat e nenit dhe 13 te Ligjit nr. 03/L-181 Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, për shkak se subjekti ekonomik është i obliguar te prezantoj dokumentacioni e kërkuar (licencën për shitje me pakice te GLN-së) dhe dokumentet e tjera për te konstatuar gjendjen faktike, ndërsa subjekti ne fjale edhe përkundër afatit ligjor nuk ka sjell. Prandaj, Aktvendimi i inspektorëve te tregut ka qenë i bazuar ne gjendjen faktike dhe masat e ndërmarra kane qene brenda kompetencave te përcaktuara me dispozitat e nenit 14 te ligjit nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut.

Provat e administruara

9. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi me nr.5042 me datë 18.08.2020 i Inspektorati i Tregut MINT, Ankesë nga paditësi AL Petrol shpk kundër aktvendimit të Inspektoratit të Tregut me nr.19 prot:4217 të datës 28.07.2020 Ref:19/20, Aktvendim Ref:19/20 nga I.T,

Procesverbal me nr.19001559, Propozim për përmbarim me nr.6259 me datë 15.09.2020, Prapësim me datë 30.09.2020 nga paditësi AL Petrol, Aktvendim me nr.2020:137211 me datë 03.11.2020, Urdhër P.Nr.177/20.

Vlerësimi i Gjykatës

10. Gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit në përputhje me nenin 41 dhe 44 të LKA- së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të paditurit si dhe pas vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.
11. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: sipas procesverbalit me nr.19/001559, në adresë të subjektit afarist “Al-Petrol” Rr. “Nëna Terezë” Komuna Gjilan, me datë 09.06.2020, Inspektorët e Tregut kanë konstatuar Llojin i Biznesit të subjektit afarist Tregti me pakice, tregti e derivateve, tregti e gazit, subjekti posedon licencë për shitje të karburanteve të datës 19.05.2021, prezenton licencën për shitje me pakicë për benzinë dhe dizel, faturat e fundit të furnizimit me benzinë dhe dizel dhe GLN. Subjekti obligohet që në afat prej 30 ditëve të dorëzoj në IT të MTI-së Licencën për shitje me pakicë të GLN dhe raport të mjeteve matëse të rrjedhjes për benzinë, dizel dhe GLN. Paditësi nuk ka vepruar sipas vendimit në procesverbal. Me Aktvendimi me nr. Prot. 19/4217 te datës 28/07/2020 Inspektori i Tregut si organ i shkallës së parë i ka shqiptuar gjobe, në vlere prej 1,000.00 (njëmijë) euro operatorit ekonomik Al Petrol sh.p.k. Kundër aktvendimit me date 03/08/2020, operatori ekonomik Al Petrol shpk ka parashtruar ankese me nr. prot. 19/4327 me te cilën ka kundërshtuar aktvendimin e nxjerr nga inspektorët e tregut.
12. E paditura pas shqyrtimit të ankesës ka nxjerr Vendim me nr. Protokolli 19/5042 te datës 18/08/2020 nga Kryeinspektori i Inspektoratit Qendror te Mbikëqyrjes së Tregut - MINT, me te cilin ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik Al Petrol shpk, ndërsa ka lënë ne fuqi Aktvendimin me nr. 19/4217 te datës 28/07/2020 me arsyetimin se inspektorët e tregut kane vepruar ne harmoni me dispozitat e nenit dhe 13 te Ligjit nr. 03/L-181 Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, për shkak se subjekti ekonomik

është i obliguar të prezantoj dokumentacioni e kërkuar (licencën për shitje me pakice të GLN-së) dhe dokumentet e tjera për të konstatuar gjendjen faktike, ndërsa subjekti në fjale edhe përkundër afatit ligjor nuk ka sjell. Operatori ekonomik Al Petrol sh.p.k. i pakënaqur me Vendimin e shkallës së dytë Kryeinspektori i IT- MINT, më datë 02/09/2020 ka parashtruar padi me kërkesë për Anulimin e Vendimit nr. 19/5042 të datës 18/08/2020.

13. Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 27 par. 4 të Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut i cili përcakton: *Kundër aktvendimit të Kryeinspektorit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.*
14. Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje.
15. Është i pabazuar pretendimi i paditësit se Vendimi i kundërshtuar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 pika 1.1 të LPA-se, sepse gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ, pjesën hyrëse, dispozitivin me të cilën urdhërohet operatori ekonomik Al Petrol ta paguaj gjobën e shqiptuar, vendimi përmban pjesën arsyetuese dhe përshkrimin të mjaftueshëm të gjendjes së konstatuar faktike, si dhe këshillën juridike. Prandaj, Vendimi i kundërshtuar është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 pika 1.1 të LPA-se.
16. Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar, është marrë në kuadër të kompetencave ligjore të Inspektoratit të tregur të përcaktuara me: Ligji Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut (LIMT) Neni 14 1. ku përcaktohet: *Subjekti ekonomik, i cili i nënshtrohet inspektimit është i detyruar të mundësojë inspektorit mbikëqyrjen*

inspektuese në pajtim me dispozitat e nenit 11 të këtij ligji. 2. Subjekti ekonomik sipas kërkesës së inspektorit, është i detyruar që menjëherë t'i ofroi të dhënat e mundshme e të nevojshme, ndërsa për raste të shtyshme sipas vlerësimit, brenda afatit të përcaktuar nga inspektori. 3. Subjekti ekonomik i cili mbikëqyret konsiderohet që nuk i ka mundësuar inspektorit kryerjen e mbikëqyrjes nga paragrafi 1. i këtij neni nëse edhe brenda afatit të përcaktuar me procesverbalin e inspektorëve, nuk siguron qasje në produkte, dokumentacionin e kërkuar të punës dhe dokumente tjera të nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike të mbikëqyrjes së filluar.

17. Është i pabazuar pretendimi i paditësit se vendimi për shqiptimin e gjobës është i pas afatshëm se nuk është marrë ne afat prej 8 ditësh nga dita e përpilimit të procesverbalit të inspektoreve të datës 09.06.2020, dhe se kaluar 48 ditë që inspektorët e tregut nuk e kanë marrë vendimin për shqiptimin e gjobës brenda afatit ligjore, sepse Neni 26 1. i LIMT përcakton kompetencat ligjore të inspektoratit: *Inspektori pas kryerjes së inspektimit ka për detyrë të hartojë procesverbal. Procesverbali gjithëherë nënshkruhet nga së paku dy (2) pjesëmarrës prezent të inspektimit dhe lëshohet në të njëjtën ditë. 2. Afati i përcaktuar me procesverbal, nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) dite. 3. Inspektori ka për detyrë që subjektit ekonomik t'i lëshoj aktvendim apo urdhër me shkrim me të cilin ose i shqiptohet një masë ose i ngarkohet një detyrë për të vepruar. 4. Aktvendimin e lëshon Inspektori brenda afatit prej tetë (8) ditësh nga dita e dorëzimit të procesverbalit.*

18. Prandaj gjykata vlerëson se Inspektorati ka konstatuar po atë ditë në procesverbal detyrimin e subjektit afarist Al Petrol sh.p.k, dhe i ka dhënë afat prej 30 ditëve siç përcaktohet me paragrafin 2. *Afati i përcaktuar me procesverbal, nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) dite, por subjekti afarist nuk ka ndërmarrë asnjë veprim sipas detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 14. 2. Subjekti ekonomik sipas kërkesës së inspektorit, është i detyruar që menjëherë t'i ofroi të dhënat e mundshme e të nevojshme, ndërsa për raste të shtyshme sipas vlerësimit, brenda afatit të përcaktuar nga inspektori. Prandaj IT e ka respektuar afatin e përcaktuar dhe pas kalimit të afatit, në pajtim me nenin 14.3 ku përcaktohet 3. Subjekti ekonomik i cili mbikëqyret konsiderohet që nuk i ka mundësuar inspektorit kryerjen e mbikëqyrjes nga paragrafi*

1. i këtij neni nëse edhe brenda afatit të përcaktuar me procesverbalin e inspektorëve, nuk siguron qasje në produkte, dokumentacionin e kërkuar të punës dhe dokumente tjera të nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike të mbikëqyrjes së filluar, prandaj Inspektori i Tregut si organ i shkallës së parë ka vepruar sipas kompetencave ligjore duke marrë vendim me nr. Prot. 19/4217 te datës 28/07/2020 me të cilin paditësit “AL Petrol” Sh.p.k i ka shqiptuar gjobe, në vlerë prej 1,000.00 (njëmijë) euro.

19. Gjykata vlerëson se gjoba e shqiptuar është në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, Neni 33 Dispozitat ndëshkuese *përcaktohet 1. Inspektori i tregut për shkeljet e konstatuara me këtë ligj i shqipton gjobat në vijim: 1.1. me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, ndëshkohet personi juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit bazik. Po ashtu sipas Ligji Nr.2004 / 5 Për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-138 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr.2004/5 Për Tregtinë Me Naftë Dhe Derivate Të Naftës Në Kosovë, Neni 4 4.1. përcakton detyrimin e subjekteve afariste dhe personave që të pajisen me licence: *Asnjë person nuk mund të merret me transport, deponim ose shitje të derivateve të naftës, brenda kapaciteteve të shitjes me shumicë dhe pakicë, për qëllime afariste, pa një licencë aktuale valide, të lëshuar nga Këshilli.**

20. Prandaj, gjykata vlerëson se e paditura Inspektorati i Tregut në MINT ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur me Vendim me nr. Protokollin 19/5042 te datës 18/08/2020 nga Kryeinspektori si organ i shkallës së dytë ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik Al Petrol shpk, ndërsa ka lënë ne fuqi Aktvendimin me nr. 19/4217 te datës 28/07/2020 sepse subjekti ekonomik AL Petrol sh.p.k është obliguar te prezantoj dokumentacioni e kërkuar -licencën për shitje me pakice te GLN-së- dhe dokumentet e tjera për te konstatuar gjendjen faktike, ndërsa nuk ka vepruar sipas detyrimit ligjor. Gjykata shqyrtoj edhe provat e tjera te administruara pr vlerëson se të njëjtat nuk janë me relevante për vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar, sepse e paditura, në procedurë administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

21. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr. 502/22 datë 25.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimt të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.